

VENDIM
Nr.551, datë 11.8.2011

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.717, DATË 23.6.2009 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE
BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.717, datë 23.6.2009, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Lidhja nr.I “Nivelet e pagës bazë për klasë në administratën e Presidentit, Kuvendit, në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrive të linjës, institucione qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2 “Nivelet e pagës bazë për klasë në institucionet rajonale dhe vendore”, përmendur në pikën 1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Në lidhjen I/I “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës në administratën e ministrive të linjës, institucioneve të pavarura e kushtetuese, institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, bëhen këto ndryshime:

c/1. Në numrin rendor 6, në klasën VIII pas fjalëve: “...Bibliotekar në Bibliotekën Shkencore të Universitetit”, shtohen fjalët “... dhe të Akademisë së Shkencave”;

c/2. Në numrin rendor 8, në klasën VI, shtohet emërtesa: “Magazinier”.

c/3. Në numrin rendor 9 në klasën V, emërtesa “Magazinier” shfuqizohet.

d) Pas lidhjes I/9, shtohet lidhja I/10 “Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë për punonjësit e Shtëpisë së Pushimit, të Ministrisë së Brendshme, Durrës”.

e) Lidhja II/1 “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës në administratën e institucioneve rajonale dhe vendore, si dhe të institucioneve qendrore, të grupit të tretë, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes”, e përmendur në pikën 5 të vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, për vitin 2011, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2011.

Ky vendim hyn në fuqi mbas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha